



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3511/11 prot

Datë 23.01.2026

V E N D I M
Nr. 126/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.01.2026 mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Posta Shqiptare me adresë Rr.“Reshit Çollaku”, Nr.,
4, Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK me NIPT K72223007O dhe adresë Njesia bashkiake nr 5, rruga Pjeter Bogdani, godina nr 3, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09-05-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

II.2. Në datën 17-07-2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.08.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200 lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING”	83,619,173.80 lekë	skualifikuar
3. “Abissnet” sh.A	93,831,840 lekë	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” sh.p.k	119,100,000 lekë	skualifikuar
5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k	119,700,457.00 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 18.08.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 27.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2304/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5736 e operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga

operatori ekonomik ankimues “One Albania” SHA, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të “Abissnet” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2304/1 datë 28.08.2025, lidhur arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “ONE ALBANIA” SHA kundërshton me anë të ankesës, si dhe kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Abissnet” SHA.

II.7. Në datën 27.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2307/2025 protokolli, datë 28.08.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5737 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje InternetIntranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MC NETËORKING” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2307/1 datë 28.08.2025, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK kundërshton me anë të ankesës, si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.

II.9. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të

interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2304/2 prot., datë 03.09.2025.

II.10. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2304/3 prot., datë 03.09.2025

II.11. Me shkresën me nr. 843/28 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 2304/4 prot., datë 08.09.2025 drejtuar operatorit ekonomik “One Albania” SHA dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “One Albania” SHA nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.12. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2307/2 prot., datë 03.09.2025.

II.13. Me shkresën me nr. 843/29 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 2307/3 prot., datë 08.09.2025 drejtuar operatorit ekonomik “Mc Networking” SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Mc Networking” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.14. Me vendimin nr. 1409/2025, datë 08.10.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “One Albania” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.*
2. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.*

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.15. Me shkresën me nr. 843/33 prot., datë 16.10.2025 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 2304/9 prot., datë 17.10.2025, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka informuar KPP se: “[.] ju informojmë se në zbatim të vendimit nr. 1409, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka ngritur urdhrin e brendshëm për rivlerësimin e ofertave dhe ka kthyer fazën e procedurës për rivlerësim në SPE.” Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar: Urdhrin e brendshëm për rivlerësim ofertash nr. 5/32, datë 13.10.2025, si dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave datë 15.10.2025.

II.16. Në datë 22.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1516/2025, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin nr. 1409/2025, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.17 Në datën 28.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200 lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING”	83,619,173.80 lekë	kualifikuar
3. “Abissnet” sh.A	93,831,840 lekë	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” sh.p.k	119,100,000 lekë	skualifikuar
5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k	119,700,457.00 lekë	skualifikuar

II.18. Me shkresën me nr. 843/35 prot., datë 07.11.2025 me lëndë “Informacion mbi zbatimin e vendimit nr. 1516/2025 datë 22.10.2025 lidhur me rivlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit REF-47282-05-07-2025 me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 2304/14 prot., datë 07.11.2025, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka informuar se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1409/2025, datë 08.10.2025.

II.19. Në datë 11.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1643/2025, ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.19. Në datën 20.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200 lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING”	83,619,173.80 lekë	skualifikuar
3. “Abissnet” sh.A	93,831,840 lekë	kualifikuar

- | | | |
|---|---------------------|--------------|
| 4. “Vodafone Albania” sh.p.k | 119,100,000 lekë | skualifikuar |
| 5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k | 119,700,457.00 lekë | skualifikuar |

II.20. Në datë 27.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.21. Në datën 09.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3511/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6154 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 Lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK.

II.22. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3511/1 datë 10.12.2025, lidhur arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK kundërshton me anë të ankesës.

II.23. Me shkresën me nr. 843/40 prot., datë 15.12.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 3511/3 prot., datë 16.12.2025 autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC Networking” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.24. Me shkresën me nr. 843/41 prot., datë 18.12.2025 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt : “Blerje internet-intranet, marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 3511/3 prot., datë 16.12.2025 autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC Networking” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.25. Me shkresën me nr. 3511/5 prot., datë 29.12.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA informacionin si vijon: “[..] Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “MC

NETWORKING” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga institucioni juaj, të dorëzoni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj nga operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar [..].

II.26. Me shkresën me nr. 846/44 prot., date 06.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3511/6 prot., datë 06.01.2026 autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacion e dorëzuar nga operatori ekonomik “MC Networking” shpk pranë Postës Shqiptare SHA në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.27. Me shkresën me nr. 843/43 prot., datë 05.01.2026 me lëndë “Mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Internet-intranet, marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 3511/7 prot., datë 07.01.2026, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar kërkesën për një vendim sa më të shpejtë lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.28. Me shkresën me nr. 843/44 prot., datë 22.01.2026 me lëndë “Kërkesë për marrjen e një vendimi sa më të shpejtë për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Internet-intranet, marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 3511/8 prot., datë 22.01.2026, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar kërkesën për një vendim sa më të shpejtë lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.29. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin administrative rezulton se janë paraqitur argumente nga subjekti i interesuar “Abissnet” SHPK në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, protokolluar me nr. 3511/2 prot., datë 16.12.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si vijon: “[...] Nga verifikimet e kryera është dorëzuar fizikisht listëpagesa për muajin Maj 2025 ku janë pasqyruar 65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës në tërësi. Kriteri i mësipërm kërkon që Operatori Ekonomik minimalisht të ketë 20 (njëzetë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike, Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike apo Telekomunikacion, të cilët po ashtu duhet të figurojnë në listëpagesën e dorëzuar. Pra, nga 20 punonjësit e deklaruar me diplomë, vetëm 18 emra punonjësish nga 20 që kërkohen në kriter gjenden në listëpagesën e dorëzuar, dhe dy nga të cilët nuk figurojnë fare si emra konkretisht personat: O.D dhe O. V. Për personat e mësipërm ekzistojnë të dorëzuara vetëm deklaratat e angazhimit sipas shtojcës 5 të DST-së, të cilat për nga rëndësia nuk mund të konsiderohen si të njëjta apo të zëvendësojnë pasqyrimin në listëpagesën e Majit 2025 në mënyrë që të quhet kriteri i përmbushur. Për më tepër që kjo formë punësimi, nuk është e përmendur në mënyrë eksplicite si formë punësimi apo angazhimi në kriterin 2.3.6, për të treguar disponueshmërinë e stafit të punësuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit të modifikuara përcaktohet kriteri si më poshtë:

Pika 2.3.6 ISHTE:

2.3.6 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a. 3 (tre) punonjës të certifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente.
- b. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti SCTE ose ekuivalente.
- c. 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente.
- d. 2 (dy) punonjës të certifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).
- e. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në siguri rrjeti.
- f. 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.
- g. 1 (një) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga

autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.
- Çertifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i çertifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmerret, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

Pika 2.3.6 BËHET:

2.3.6 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të **paktën 20 (njëzet)** punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të çertifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a. 3 (tre) punonjës të çertifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente.
- b. 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente.
- c. 2 (dy) punonjës të çertifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).
- d. 2 (dy) inxhinierë të çertifikuar në siguri rrjeti.
- e. 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.
- f. 1 (një) punonjës i çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë çertifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga

autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.*
- *Çertifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara*
- ***Listëpagesave sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.***

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i çertifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmarrë, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

III.1.2. Referuar shkresës me nr. 846/44, datë 06.01.2026, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3511/6 prot., datë 06.01.2026, dorëzuar nga Posta Shqiptare SHA rezulton, se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ndër të tjera ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të nënshkruar dhe vulosur;
- Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” Muaji maj;
- Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” Muaji Qershor;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. E. L;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. O. B;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. Xh.G;
- Certifikatë mbi sigurimin teknik lëshuar nga TCPE në emër të z. B. L;
- Certifikatë Hewlett Packard Enterprise Hereby Awards në emër të z. E. D;
- Certifikatë mbi sigurimin teknik lëshuar nga TCPE në emër të z. K. K;
- Certifikatë Cybersecurity Architect Expert në emër të z. A. B;

- Certifikatë Fortinet Certified Associate in Cybersecurity në emër të z. Xh. G;
- Certifikatë MTCSE në emër të z. Xh. G;
- Certifikatë Google Project Management në emër të z. E. D;
- Certifikatë Project Management në emër të z. E. B;
- Certifikatë ITIL në emër të z. A.B;
- Certifikatë ITIL në emër të z. E. B;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. O. D;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. E. C;
- Certifikatë Hewlett Packard Enterprise Hereby Awards në emër të z. E. L;
- Certifikatë MTCSE në emër të z. O. D;
- Certifikatë MTCSE në emër të z. E. L;
- Diplomë në Inxhinieri Telekomunikacioni në emër të z. Xh. V. G + Master i shkencave;
- Diplome ne Informatikë Ekonomike në emër të znj. F.V. Z;
- Diplomë ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të z. A. A. B;
- Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. A. M.F;
- Diplomë ne Teknologji Informacioni në emër të z. B. Sh. L;
- Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. B. N. Gj;
- Diplomë në Informatikë Ekonomike në emër të znj. E. A. T;
- Diplomë në Informatikë në emër të z. E. A. Ç + master i shkencave në Informatikë;
- Diplomë në Informatikë Biznesi në emër të z. I. I.A;
- Diplomë në Informatikë në emër të z. I. A.F;
- Diplomë në Teknologji Infomacioni dhe Komunikimi në emër të znj. I. Xh. M;
- Diplomë në Teknologji Informacioni emër të z. K. K.V;
- Diplomë në Inxhinieri Kompjuterike në emër të znj. M. I. B;
- Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të z. O. Q. B;
- Diplomë në Inxhinieri Informatike në emër të znj. E. E. F;
- Diplomë në Inxhinieri Softwerike në emër të znj. A. M. L;
- Diplomë në Informatikë Ekonomike në emër të znj. F. S.K;
- Diplomë në Inxhinieri Telekomunikacioni në emër të z. E. H. B;
- Diplomë në Inxhinieri Elektronike në emër të z. O.P. D;
- Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të znj. O. R. V;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.1.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën ”

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë

e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pikën 2.3.6 ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, duhet të paraqesin: Diplomat Universitare, Çertifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara, si dhe **Listëpagesave sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.** KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar, të verifikohet se operatorët ekonomikë të kenë staf të kualifikuar për kryerjen e kësaj pune si dhe stafi i deklaruar të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

III.1.9. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 846/44 prot., datë 06.01.2026, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik për të plotësuar kriterin e mësipërm ka dorëzuar diplomat, certifikatat/dëshmitë si dhe listëpagesat e muajit maj 2026, si dhe ka dorëzuar si dokumentacion plotësues listëpagesat e muajit qershor 2026 (protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 2203 prot., datë 19.11.2025).

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.6 të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të dorëzojë **Listëpagesave sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.** Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e vendimit të KVO-së me arsyetimin se: *“[...] Kemi përcaktuar Muajin Qershor 2025, pasi data e zhvillimit të procedurës së mësipërme të prokurimit është data 17.07.2025 dhe më datë 01.05.2025 kemi lidhur kontratën e punës (në bazë të Kodit të Punës) me inxhinierin Elektronik z. Olsi Deda, me hyrje në fuqi në datën 01.06.2025 dhe në datë 04.06.2025 e kemi deklaruar punësimin e tij në Sistemin E-filling të Drejtorisë së Tatimeve, kemi deklaruar pagën e tij në Listëpagesën E-sig 025 të muajit Qershor 2025, në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 9136 datë*

11.09.2023 “Për Mbledhjen E Kontributeve Të Detyrueshme Të Sigurimeve Shoqërore Dhe Shëndetësore në Republikën E Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe më datë 04.06.2025 kemi lidhur kontratën e punës (në bazë të Kodit të Punës) me inxhinieren e Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimi znj. Orjada Vrenosi, me hyrje në fuqi në datën 18.06.2025 dhe e kemi deklaruar punësimin e saj në Sistemin E-filling të Drejtorisë së Tatimeve, kemi deklaruar pagën e saj në Listëpagesën E-sig 025 të muajit Qershor 2025, në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 9136 datë 11.09.2023 “Për Mbledhjen E Kontributeve Të Detyrueshme Të Sigurimeve Shoqërore Dhe Shëndetësore në Republikën E Shqipërisë” i ndryshuar. (Bashkëlidhur dokumentacioni vërtetues i gjeneruar nga Sistemi E-filling i Drejtorisë së Tatimeve)”, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit dhe dokumentave të dorëzuara nga operatori ekonomik pranë autoritetit kontraktor Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomik të dorëzojnë listëpagesën e muajit të fundit të deklaruar, në përmbushje të të cilit operatori ekonomik ka dorëzuar listëpagesën e muajit maj dhe si dokumentacion shtesë në datë 19.11.2025, ka dorëzuar listëpagesën e muajit qershor. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “kontratat për punonjësit O.D dhe O.V janë lidhur në maj dhe kanë hyrë në fuqi në qershor”, Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomikë, në datën e zhvillimit të procedurës, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme. Akoma më tej Komisioni gjykon, se kriteri i kërkuar nga autoriteti kontraktor është evaziv pasi nuk ka përcaktuar qartësisht nëse duhej të dorëzohej deklarata e muajit maj apo deklarata e muajit qershor. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik sipas të cilit kontrata me punonjësit z.O. D dhe znj. O.V është lidhur në maj, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet ti kërkojë sqarime operatorit ekonomik, të verifikojë dokumentacionin dhe të verifikojë nëse këto kontrata janë lidhur para datës së zhvillimit të procedurës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Mc Networking” SHPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si vijon: “Gjithashtu, për punonjësit: E. L, E. D dhe K. K nuk janë dorëzuar fizikisht Diplomë përkatëse Universitare ashtu sikurse parashikon kriteri më sipër, prandaj nuk mund të konsiderohen pjesë e stafit të punësuar prej 20 punonjësish me diplomë sipas fushave të kërkuara në kriter.

→ Për më tepër, edhe certifikatat e dorëzuara për punonjësit nuk janë ato që janë kërkuar në kriterin e DST-së, konkretisht:

1. Punonjësi “K. K” rezulton se ka dorëzuar një certifikatë “TCPE”. Ky lloji certifikimi mundësohet nga një trup certifikimi “TCPE” sh.p.k., që në thelb të tij akrediton dhe certifikon personelin elektrik si dhe funksionon si një organizëm inspektimi për pajisjet dhe instalimet elektrike në përputhje me “Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për impiantet, pajisjet

dhe instalimet elektrike”, Nr.3403/1 Prot., datë 30.06.2003, miratuar nga “Ministria e Industrisë dhe Energjitikës”.

Fusha e certifikimit duket qartë edhe në objektin e veprimtarisë së biznesit në QKB, ku kompania “TCPE” sh.p.k. është regjistruar me veprimtarinë e mëposhtme:

“Certifikimi mbi sigurinë elektrike të punonjësve që punojnë me pajisjet elektrike ose në afërsi të tyre. Certifikimi i instalatorëve për pajisjet dhe impiantet elektrike për tension nën 1000 V. Certifikimi i instalatorëve për linjat elektrike për tension nën 1000V. Inspektimi i instalimeve elektrike në ambientet e zakonshme. Inspektimi i impianteve elektrike në ambientet me rrezik zjarri. Inspektimi i impianteve mbrojtëse nga rrufeja. Inspektimi i linjave ajrore TU e TL. Inspektimi i impianteve të tokëzimit të çdo lloji. Inspektimi i kabinave elektrike TU e TL. Inspektimi i linjave kabllore TU e TL. Inspektimi i nënstacioneve dhe impianteve shpërndarëse të TL. Zhvillimi i trajnimeve në fushën elektrike.”

Theksojmë se kjo trupë certifikon personelin bazuar në standardet “S SH EN ISO/ IEC 17024:2012” dhe “S SH EN ISO/ IEC 17020:2012” dhe në të gjithë dokumentacionin që lidhet me certifikimin dhe inspektimin në fushën elektrike. Pra ky certifikim tregon qartazi se është i fokusuar në punimet me impiante, pajisje elektrike, instalime elektrike apo në fusha të përafërta me këto të fundit. Ky fakt tregohet qartë në faqen zyrtare të “Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” në linkun bashkëlidhur: <https://dpa.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/TCPE-total.pdf>. Si dhe në certifikatën për akreditimin e kësaj trupe certifikuese nënvizohet qartë se “TCPE” sh.p.k.: “Akreditohet si organizëm çertifikimi personeli që certifikon personelin elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me standardin S SH EN ISO/IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit- Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli”. Gjithashtu, në programin shoqërues për certifikimin e trupave për personel elektrik, jepet shprehimisht tabela e specialiteteve elektrike që certifikohen si më poshtë:

Nr. Personat ose grup personat Standardi ose dokument tjetër normativ (ose pjesë të tij) Titulli i standardit ose dokumentit tjetër normativ

1. Certifikimi i Punonjësve Elektrik për Sigurimin Teknik Urdhri Nr. 3403/1, Prot. 30.06.2003 nga “Ministri i Industrisë dhe Energjitikës” Rregullorja e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Instalimet dhe Pajisjet Elektrike. Skema e Certifikimit të Personelit Elektrik, Rishikimi 2, datë 15.04.2019 Kodi TCPE-FO-039 Rishikim 2, datë 15.04.2019.

2. Certifikimi i instaluesve të instalimeve elektrike të TL mbi 1000V VKM 483/2020, “Per Miratimin e Rregullit Për Kushtet Teknike Dhe Garantimin e Sigurisë së Instalimeve Elektrike të Tensionit të lartë, Mbi 1 KV. Rregullorja e Sigurimit Dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Instalimet dhe Pajisjet Elektrike. Skema e Certifikimit të instaluesve, të instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 Kv, Kodi TCPE – SC – 001, Rishikimi 1, datë 07.07.2020. 3. VKM 482/2020, “Për Miratimin e Rregullës Teknike”, “Për Kushtet Teknike dhe Garantimin e Sigurisë së Linjave Elektrike me Tension të Lartë” Mbi 1 Kv, Rregullorja e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Instalimet dhe Pajisjet Elektrike. Skema për certifikimin e Instaluesve të Linjave të Tensionit të Lartë mbi 1 kV, Kodi TCPE-SC002, Rishikimi 1, datë 07.07.2020. 4 Certifikimi i personelit teknik elektrik Rregullorja e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Instalimet

dhe Pajisjet Elektrike. Skema për certifikimin e specialistëve elektrik, që punojnë në pajisjet apo instalimet në TU/TM, Kodi TCPE SC-003, Rishikimi 1, datë 07.07.2020. Nga ana tjetër, Certifikata e kërkuar në kriter ajo “SCTE” (Society of Cable and Telecommunications Engineers) apo ekuivalentet e saj kanë në bazën e tyre të zbatimit specializimin në lidhje me rrjetet e telekomunikacionit dhe broadband si fibër, teknologji komunikimi kabllor apo teknologji të tjera komunikimi sikurse mund edhe të evidentohet qartë në faqen zyrtare të “SCTE” në linkun e mëposhtëm: <https://account.scte.org/education/certification/professional-certifications/> Ndërkaq, në këtë faqe (<https://account.scte.org/standards/library/catalog/>) mund të gjenden të gjitha standardet që ndjek dhe zbaton “SCTE” dhe në asnjë nga standardet e saj nuk rezultojnë të gjendshme standardet “S SH EN ISO/ IEC 17024:2012” dhe “S SH EN ISO/ IEC 17020:2012” të certifikatës “TCPE” të dorëzuar nga Operatori Ekonomik “MC Networking”. Pra, certifikimi “TCPE”, nga kompania “TCPE” sh.p.k., i jepet një teknik në mënyrë që të lejohet hyrja e tij në impiante apo ambiente ku ka pajisje elektrike, për t’u siguruar që ai ka njohuritë e duhura elektrike, për të punuar në një ambient të tillë, por nuk tregon asgjë në lidhje me certifikimet për punët teknike të instalimeve të telekomunikacionit (fibër, cable, antenna) që përfshihen në certifikatat “SCTE” (Society of Cable and Telecommunications Engineers) apo ekuivalentet me to. Ajo që do të konsiderohej si ekuivalente me një certifikim teknik “SCTE”, do të ishte një certifikim në fushën e telekomunikacionit ose broadband-it, si për shembull: → FOA CFOT (Certified Fiber Optic Technician – Teknik i Certifikuar për Fibër Optike); → BICSI Installer / OSP (Instalues ose Specialist për rrjete të jashtme); → Certifikime NCTI për teknikë broadband; → Trajnime CableLabs DOCSIS; → Certifikime të prodhuesve të pajisjeve telekom (Huawei, Nokia, Cisco për rrjete akses). Certifikatat për punë elektrike “TCPE”, si në impiante elektrike apo afër tyre, nuk përbëjnë ekuivalencë pasi ato dëshmojnë njohuri për sigurinë elektrike dhe jo për aftësinë teknike në fushën e broadband-it apo telekomunikacionit. Për sa më sipër, punonjësi Klement Kapedani, nuk i plotëson njëkohësisht të treja pikat e kriterit 2.3.6 për të vërtetuar disponueshmërinë e stafit të punësuar dhe plotësimin e kapaciteteve teknike.

2. Punonjësi “B.L” rezulton të ketë dorëzuar një certifikatë “TCPE” me Nr. 003566 “Mbi Sigurimin Teknik”. Vlen i njëjti arsyetim si për punonjësin “K. K”. Nuk i plotëson njëkohësisht të treja pikat e kriterit 2.3.6 për të vërtetuar disponueshmërinë e stafit të punësuar dhe plotësimin e kapaciteteve teknike. Duke qënë se kriteri i disponueshmërisë së stafit është thelbësor dhe jo formal, si edhe faktit që kjo vërtetohet vetëm duke u siguruar që 20 punonjësit e kërkuar disponojnë njëkohësisht të treja pikat e mëposhtme të kërkuara në DST: → Diplomat Universitare për secilin nga 20 punonjësit e specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit. → Certifikatat/Dëshmi të vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara. → Listëpagesa sipas formularit E- Sig 25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Operatori Ekonomik “MC NETWORKING” sh.p.k., ka rezultuar se ka mangësi në deklaratimet e punonjësve të tij në listëpagesën e dorëzuar, parregullsi në certifikimet e kërkuara, si dhe mungesë dokumentacioni të plotë përsa i përket diplomave të

dorëzuara, arsye të cilat përbëjnë shkak për mosgarantimin e përputhshmërisë me kërkesat e “Autoritetit Kontraktor” dhe mosplotësimin e kriterëve të DST-së. Tabela më poshtë tregon në mënyrë të përmbledhur mangësitë e konstatuara gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik për certifikimet profesionale. Kërkesa Plotësohet Punonjësit 3 (tre) punonjës të certifikuar të rrjetit “Cisco” (CCNA) ose ekuivalente; PO O. B, E. C, Xh.G- kanë certifikata “MTCNA” ekuivalente me “CCNA”. 2 (dy) teknik të certifikuar në nivel teknik “SCTE” ose ekuivalente; JO K.K-S’kualifikohet, sepse nuk ka diplomë universitare, si edhe certifikata “TCPE” nuk është ajo e kërkuara në kriter (certifikim për personel elektrik); B.L- S’kualifikohet sepse certifikata “TCPE” nuk është ajo e kërkuara në kriter (certifikim për personel elektrik). 2 (dy) punonjës të certifikuar në siguri informacioni (cybersecurity); PO A. B, Xh.G. 2 (dy) inxhinier të certifikuar në siguri rrjeti; JO Xh.G- e saktë E. L- S’kualifikohet pasi nuk ka diplomë universitare; O. D-S’kualifikohet pasi nuk figuron fare në listëpagesën E-Sig. 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve “PMP” ose ekuivalent; PO E.B- ka certifikatë “Prince 2” ekuivalente me “PMP”. 1 (një) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalent. PO A.B-Ka certifikatë “ITIL”;

E.B-Ka certifikatë “ITIL”. Si konkluzion, punonjësit që kanë diplomën e kërkuar dhe janë në listëpagesën E-Sig të muajit Maj 2025, janë 18 (tetëmbëdhjetë) dhe jo 20 (njëzetë), sikurse kërkohet në kriterin 2.3.6 pjesë integrale e DST-së në lidhje me stafin e punësuar pranë Operatorit Ekonomik. Si dhe personeli që përmbush kërkesat në lidhje me certifikimet e kërkuara është vetëm 8 (tetë) punonjës dhe jo 11 (njëmbëdhjetë) sikurse kërkohet nga kriteri 2.3.6”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit të modifikuara përcaktohet kriteri si më poshtë:

Pika 2.3.6 ISHTE:

2.3.6 *Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:*

- h. 3 (tre) punonjës të certifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente.*
- i. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti SCTE ose ekuivalente.*
- j. 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente.*
- k. 2 (dy) punonjës të certifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).*
- l. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në siguri rrjeti.*

- m. 1 (një) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.
- n. 1 (nje) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.
- Certifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmerret, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

Pika 2.3.6 BËHET:

2.3.6 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të **paktën 20 (njëzet)** punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- g. 3 (tre) punonjes të certifikuar të rrjetit Cisco (CCNA) ose ekuivalente.
- h. 2 (dy) teknike te certifikuar ne nivel teknik SCTE ose ekuivalente.
- i. 2 (dy) punonjes të certifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).
- j. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në siguri rrjeti.

- k. 1 (një) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.
- l. 1 (nje) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.
- Certifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara
- **Listëpagesave sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmarrë, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

III.2.2. Referuar shkresës me nr. 846/44, datë 06.01.2026 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3511/6 prot., datë 06.01.2026, dorëzuar nga Posta Shqiptare SHA rezulton, se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ndër të tjera ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të nënshkruar dhe vulosur;
- Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” Muaji maj;
- Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” Muaji Qershor;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. E. L;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. O. B;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. Xh.G;

- Certifikatë mbi sigurimin teknik lëshuar nga TCPE në emër të z. B. L;
- Certifikatë Hewlett Packard Enterprise Hereby Awards në emër të z. E. D;
- Certifikatë mbi sigurimin teknik lëshuar nga TCPE në emër të z. K. K;
- Certifikatë Cybersecurity Architect Expert në emër të z. A. B;
- Certifikatë Fortinet Certified Associate in Cybersecurity në emër të z. Xh. G;
- Certifikatë MTCSE në emër të z. Xh. G;
- Certifikatë Google Project Management në emër të z. E. D;
- Certifikatë Project Management në emër të z. E. B;
- Certifikatë ITIL në emër të z. A.B;
- Certifikatë ITIL në emër të z. E. B;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. O. D;
- Certifikatë MTCNA në emër të z. E. C;
- Certifikatë Hewlett Packard Enterprise Hereby Awards në emër të z. E. L;
- Certifikatë MTCSE në emër të z. O. D;
- Certifikatë MTCSE në emër të z. E. L;
- Diplomë në Inxhinieri Telekomunikacioni në emër të z. Xh. V. G + Master i shkencave;
- Diplome ne Informatikë Ekonomike në emër të znj. F.V. Z;
- Diplomë ne Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të z. A. A. B;
- Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. A. M.F;
- Diplomë ne Teknologji Informacioni në emër të z. B. Sh. L;
- Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. B. N. Gj;
- Diplomë në Informatikë Ekonomike në emër të znj. E. A. T;
- Diplomë në Informatikë në emër të z. E. A. Ç + master i shkencave në Informatikë;
- Diplomë në Informatikë Biznesi në emër të z. I. I.A;
- Diplomë në Informatikë në emër të z. I. A.F;
- Diplomë në Teknologji Infomacioni dhe Komunikimi në emër të znj. I. Xh. M;
- Diplomë në Teknologji Informacioni emër të z. K. K.V;
- Diplomë në Inxhinieri Kompjuterike në emër të znj. M. I. B;
- Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të z. O. Q. B;
- Diplomë në Inxhinieri Informatike në emër të znj. E. E. F;
- Diplomë në Inxhinieri Softwerike në emër të znj. A. M. L;
- Diplomë në Informatikë Ekonomike në emër të znj. F. S.K;
- Diplomë në Inxhinieri Telekomunikacioni në emër të z. E. H. B;
- Diplomë në Inxhinieri Elektronike në emër të z. O.P. D;
- Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të znj. O. R. V;

III.2.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhироja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet se është plotësuar sipas Shtojcës 10 të dokumenteve të tenderit. Referuar pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konstatohet, se ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.” Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës me anë të shkresës nr.3511/5 prot., datë 29.12.2025, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK, i renditur i pari.

Nëpërmjet shkresës me nr. 846/44 prot., datë 06.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3511/6 prot., datë 06.01.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i dorëzuar fizikisht pranë këtij të fundit, nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK.

III.2.8. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Mc Networking”, SHPK në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ka deklaruar se disponon 65 punonjës, duke listuar 23 prej tyre, për të cilët ka përcaktuar gjeneralitetet, diplomimin/certifikimet.

Sa më sipër, konstatohet, se operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK ka plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, ku në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit për pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ka kërkuar: “2.3.6 **2.3.6** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të **paktën 20 (njëzet)** punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të çertifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- m. 3 (tre) punonjes të çertifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente.**
- n. 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente.**
- o. 2 (dy) punonjes të çertifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).**

- p. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në siguri rrjeti.*
- q. 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.*
- r. 1 (një) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.*

Shënim: *Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.*

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.*
- Certifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara*
- Listëpagesave sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM, i ndryshuar, pas kualifikimit të tij, konstatohet, se operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacion e listuar në nenin III.2.2 të këtij vendimi.

III.2.9. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar, Diplomë në Inxhinieri Telekomunikacioni në emër të z. Xh. V. G + Master i shkencave; Diplome në Informatikë Ekonomike në emër të znj. F.V. Z; Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të z. A. A. B; Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. A. M.F; Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. B. Sh. L; Diplomë në Teknologji Informacioni në emër të z. B. N. Gj; Diplomë në Informatikë Ekonomike në emër të znj. E. A. T; Diplomë në Informatikë në emër të z. E. A. Ç + master i shkencave në Informatikë; Diplomë në Informatikë Biznesi në emër të z. I. I.A; Diplomë në Informatikë në emër të z. I. A.F; Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të znj. I. Xh. M; Diplomë në Teknologji Informacioni emër të z. K. K.V; Diplomë në Inxhinieri Kompjuterike në emër të znj. M. I. B; Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të z. O. Q. B; Diplomë në Inxhinieri Informatike në emër të znj. E. E. F; Diplomë në Inxhinieri Softwerike në emër të znj. A. M. L; Diplomë në Informatikë Ekonomike në emër të znj. F. S.K; Diplomë në Inxhinieri Telekomunikacioni në emër të z. E. H. B; Diplomë në Inxhinieri Elektronike në emër të z. O.P. D; Diplomë në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në emër të znj. O. R. V, pra në total rezultojnë

se operatori ekonomik ka dorëzuar diplomat përkatëse për 20 punonjës, nga 23 punonjës të listuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke plotësuar në këtë mënyrë kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.6, sipas të cilit operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën **20 (njëzetë) punonjës** të diplomuar, në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Informatikë Ekonomike/ Telekomunikacion.

Sa më sipër arsyetuar, arsyeja e skualifikimit të KVO-së, se punonjësit që kanë diplomën e kërkuar dhe janë në listëpagesën E-Sig të muajit Maj 2025, janë 18 (tetëmbëdhjetë) dhe jo 20 (njëzetë), nuk qëndron, pasi në total operatori ekonomik ka deklaruar 65 punonjës, prej të cilëve për 20 prej tyre ka deklaruar diplomat përkatëse, të cilat rezultojnë të jenë dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor duke përmbushur kështu kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.6, të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit sipas të cilit operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën **20 (njëzetë) punonjës** të diplomuar, në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Informatikë Ekonomike/ Telekomunikacion.

Sa më sipër, KPP gjykon, se nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacioni i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në përputhje me nenin 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, konstatohet, se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me kriterin e kualifikimit në pikën 2.3.6, të modifikuar në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor, lidhur me dorëzimin e diplomave për të **paktën 20 (njëzetë) punonjës** të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion.

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Sa më sipër gjykojmë, se kërkesat e mësipërme, duhet të përmbushen nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit në respektim të nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM, i ndryshuar, dhe pas klasifikimit të ofertave, operatori ekonomik i kualifikuar i pari në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM, i ndryshuar, pas kërkesës së autoritetit kontraktor, duhet të paraqesë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, me qëllim provueshmërinë e deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK, pranë

autoritetit kontraktor, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm me qëllim vërtetimin e deklarimeve të tij në formularin përmbledhës së vetëdeklarimit, sipas kërkesave në pikën 2.3.6 të Kriterëve të Kualifikimit, konkretisht lidhur me paraqitjen e diplomave për të paktën 20 punonjës, rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mc Networking” SHPK për këtë pikë qëndron.

III.3.1 Lidhur me arsyen e skualifikimit se: *“Punonjësi “K.K” rezulton se ka dorëzuar një certifikatë “TCPE”, Punonjësi “B.L” rezulton të ketë dorëzuar një certifikatë “TCPE” me Nr. 003566 “Mbi Sigurimin Teknik” [...]”. Pra, certifikimi “TCPE”, nga kompania “TCPE” sh.p.k., i jepet një tekniku në mënyrë që të lejohet hyrja e tij në impiante apo ambiente ku ka pajisje elektrike, për t’u siguruar që ai ka njohuritë e duhura elektrike, për të punuar në një ambient të tillë, por nuk tregon asgjë në lidhje me certifikimet për punët teknike të instalimeve të telekomunikacionit (fibër, cable, antenna) që përfshihen në certifikatat “SCTE” (Society of Cable and Telecommunications Engineers) apo ekuivalentet me to”*

[...] Për sa më sipër, punonjësi K. K, nuk i plotëson njëkohësisht të treja pikat e kriterit 2.3.6 për të vërtetuar disponueshmërinë e stafit të punësuar dhe plotësimin e kapaciteteve teknike.

2. Punonjësi “B.L” rezulton të ketë dorëzuar një certifikatë “TCPE” me Nr. 003566 “Mbi Sigurimin Teknik”. Vlen i njëjti arsyetim si për punonjësin “K. K.

*[...] (dy) teknik të certifikuar në nivel teknik “SCTE” ose ekuivalente; JO K.K
S’kualifikohet, sepse nuk ka diplomë universitare, si edhe certifikata “TCPE” nuk është ajo e kërkuara në kriter (certifikim për personel elektrik);*

B. L- S’kualifikohet sepse certifikata “TCPE” nuk është ajo e kërkuara në kriter (certifikim për personel elektrik)”, Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se certifikimi SCTE dhe certifikimi TCPE janë të dy certifikime në fushën teknike, për implementim teknik dhe jo akademike. Nga analiza e qëllimit dhe përmbajtjes rezulton se, si certifikata TCPE ashtu edhe SCTE synojnë verifikimin e kompetencave teknike profesionale në fushën e instalimeve, lidhjeve kabllore, pra në thelb qëllimi funksional i të dyjave është i njëjtë: garantimi i aftësisë teknike të personelit për kryerjen e shërbimeve teknike të kërkuara. Certifikimi TCPE mbulon elementët teknike që përputhen me kompetencat bazë të certifikuara nga SCTE konkretisht parimet e transmetimit të sinjalit, infrastruktura e rrjeteve kabllore, standardet e instalimit dhe sigurisë. Pra, në këto kushte edhe pse metodologjia e certifikimit ndryshon, rezultati teknik është ekuivalent, pasi të dy certifikimet mundësojnë certifikimin për të kryer detyrën teknike në terren. Certifikimi TCPE mundëson certifikimin për aftësitë teknike për instalime elektrike, ndërsa certifikimi SCTE ofron certifikime për broadband/cable/fiber që janë të dizenuara për punë reale në terren, pra të dyja certifikimet në thelb kanë të bëjnë me certifikimin e aftësive teknike për instalime në terren. Pra vetë certifikimi SCTE (sidomos track-et premises/outside plant/fiber) dokumenton kompetenca terreni për instalim, testim dhe troubleshooting të infrastrukturës broadband nga rrjeti i aksesit deri te ambienti i klientit. Certifikimi TCPE bën certifikimin e instalatorëve për pajisjet dhe impiantet elektrike. Pra në thelb certifikimet SCTE dhe TCPE garantimi i aftësisë teknike të personelit për

kryerjen e shërbimeve teknike të kërkuara, si rrjedhojë rezultati teknik është ekuivalent, pasi të dy certifikimet mundësojnë certifikimin për të kryer detyrën teknike në terren.

III. 3.2 Nisur nga arsyeja e skualifikimit sipas të cilës operatori ekonomik nuk përmbush kërkesën për “ (dy) teknik të certifikuar në nivel teknik “SCTE” ose ekuivalente; JO K.K- S’kualifikohet, sepse nuk ka diplomë universitare, si edhe certifikata “TCPE” nuk është ajo e kërkuara në kriter (certifikim për personel elektrik);

B. L- S’kualifikohet sepse certifikata “TCPE” nuk është ajo e kërkuara në kriter (certifikim për personel elektrik)”, si dhe nga verifikimi i Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ndër të tjera në Pjesën III. Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, pika B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, ka deklaruar punonjës B. L-teknik Fibre, E. D teknik rrjeti, E.L teknik rrjeti, K.K-teknik fibre.

Akoma më tej, referuar arsyetimit të mësipërm, arsyetimet e skualifikimit të operatorit ekonomik si dhe pretendimit të ngritur në ankesë nga operatori ekonomik ankimues me arsyetimin se: “[...] SË TRETI: PO EVIDENTOJMË CERTIFIKATAT E DORËZUARA NGA KOMPANIA JONË NË DOKUMENTACIONIN FIZIK, SI MË POSHTË: 1. Certifikata nr. 003565 e lëshuar nga Trupa Certifikuese e TCPE (e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Shtetit Shqipëtar) për z. K. K, i certifikuar “TEKNIK FO (Fibër Optike)” 2. Certifikata nr. 003566 e lëshuar nga Trupa Certifikuese e TCPE (e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Shtetit Shqipëtar) për z. B. L, i certifikuar “TEKNIK FO (Fibër Optike)” 3. Certifikatë e datës 18 Qershor 2025, e lëshuar nga kompania “Hewlett Packard Enterprise” (HPE) për z. E.L, i certifikuar si “Aruba Certified Network Technician” (HPE Aruba Networking Certified Network Technician)” [Teknik i certifikuar i Rrjetit në Aruba” (Teknik i certifikuar i Rrjetit në Aruba Networking HPE)] 4. Certifikatë e datës 17 Qershor 2025, e lëshuar nga kompania “Hewlett Packard Enterprise” (HPE) për z. E.D, i certifikuar si “Aruba Certified Network Technician” (HPE Aruba Networking Certified Network Technician)” [Teknik i certifikuar i Rrjetit në Aruba” (Teknik i certifikuar i Rrjetit në Aruba Networking HPE)”, edhe vetë operatori ekonomik e pranon se për përmbushjen e kërkesës së autoritetit kontraktor për 2 (dy) teknik të certifikuar në nivel teknik “SCTE”ose ekuivalente; ka deklaruar punonjës K.K, B. L, E. L dhe E.D.

Referuar arsyetimit të KVO-së, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, pranë autoritetit kontraktor në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, rezulton se, operatori ekonomik për punonjës K. K, E.L dhe E. D nuk ka dorëzuar diplomat përkatëse, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.6 të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit.

Komisioni gjykon, se edhe në kushtet kur operatori ekonomik ka dorëzuar certifikatat për plotësimin e kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.6 (b), konkretisht për **2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente**, në kushtet kur për punonjës z. K.K, E. L dhe E.D nuk ka dorëzuar Diplomat Universitare, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit të pikës 2.3.6 (b), pasi kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 janë kushte kumulative, të cilat duhet të përmbushen njëkohësisht për të quajtur të përmbushur kriterin e

veçantë të kualifikimit. Në këto kushte Komisioni gjykon, se aryseja e skualifikimit të KVO-së konkretisht për 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente është e drejtë dhe qëndron.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti-shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e lex specialis për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e 11 Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas

Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

